

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6124  
E shtunë, 26 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

Të hënën pritet të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi, asocioni nuk është në agjendë FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EULEX-i ka bastisur të premtën zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK)

## EULEX-i ARRESTON DY UDHËHEQËSIT E OVLUÇK-së, GUCATIN DHE HARADINAJN

Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka bastisur të premtën zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK). Gjatë këtij aksioni, në të cilin kanë marrë pjesë edhe hetuesit e Gjykatës Speciale, është arrestuar kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, i cili është dërguar për Hagë. Ndërkaq vetëm dy orë më vonë është arrestuar edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Arsyet e arrestimit të tyre nuk janë bërë të ditura. As Gucati dhe as Haradinaj asnjëherë më parë nuk janë intervistuar nga Gjykata Speciale FAQE 4-5

nën kryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Arsyet e arrestimit të tyre nuk janë bërë të ditura. As Gucati dhe as Haradinaj asnjëherë më parë nuk janë intervistuar nga Gjykata Speciale FAQE 4-5

nën kryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Arsyet e arrestimit të tyre nuk janë bërë të ditura. As Gucati dhe as Haradinaj asnjëherë më parë nuk janë intervistuar nga Gjykata Speciale FAQE 4-5

### AKTUALE

**RREZIQET E NJË BREXITI PA MARRËVESHJE** F. 2

**BETOHEN KADETËT E RINJ TË FSK-së** F. 6

**NIS PROGRAMI I AKADEMISË DIPLOMATIKE KOMBËTARE** F. 2



### EKONOMI

**BORDI I PËRKOHSHËM DHE AKSIONARI VLERËSOJNË LART PERFORMANCËN E KEK-ut** F. 8

**HOTI DISKUTON PËR PROJEKTET KAPITALE ME PËRFAQËSUESIT E DFC-së** F. 8



### SPORT

**NIXHA: LIGA UNIKE, SFIDË PËR TË GJITHË** F. 14



## DËSHTON SËRISH VOTIMI I PROJEKTLIGJIT PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE COVID



Edhe në seancën e së premtes të Kuvendit të Kosovës ka dështuar të votohet Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Për këtë projektligj nuk pati kuorum në Kuvendin e Kosovës, pasi për të votuan vetëm 60 deputetë. Për të kaluar ky projektligj duheshin 61 vota. Kjo është hera e tretë që dështon ky projektligj në Kuvendin e Kosovës. Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për seancën e ardhshme FAQE 8-9

pati kuorum në Kuvendin e Kosovës, pasi për të votuan vetëm 60 deputetë. Për të kaluar ky projektligj duheshin 61 vota. Kjo është hera e tretë që dështon ky projektligj në Kuvendin e Kosovës. Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për seancën e ardhshme FAQE 8-9

Edhe në seancën e së premtes të Kuvendit të Kosovës ka dështuar të votohet Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Për këtë projektligj nuk pati kuorum në Kuvendin e Kosovës, pasi për të votuan vetëm 60 deputetë. Për të kaluar ky projektligj duheshin 61 vota. Kjo është hera e tretë që dështon ky projektligj në Kuvendin e Kosovës. Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për seancën e ardhshme FAQE 8-9

## MINISTRI ZEMAJ PARALAJMËRON LEHTËSIM TË MASAVE FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Rreziqet e një Brexiti pa marrëveshje

LONDËR, 25 SHTATOR - Sipas gjetjeve të një raporti të publikuar së fundmi, Britania pritet të përballet me probleme të mëdha në portet e saj apo me mungesë të artikujve ushqimorë nëse nuk arrin një marrëveshje tregtare me Bashkimin Evropian përpara fundit të vitit.

Periudha e tranzicionit për daljen e vendit nga Bashkimi Evropian përfundon më 31 dhjetor dhe ndërsa afati po afron, marrëdhëniet po përkeqësohen.

Britania dhe BE-ja po akuzojnë njëra-tjetër për hipokrizi në negociata. Ndërkohë pandemia e koronavirusit mund ta bëjë edhe më kompleks ndikimin e një Brexiti pa marrëveshje.

Trageti që lidh Doverin me Kalenë dhe Eurotunneli që lidh Britaninë me Francën janë arteriet jetike të tregtisë së Britanisë me Evropën.

Rreth katër milionë kamionë përdorin këto vendkalime çdo vit. Me përfundimin e periudhës së tranzicionit për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, shumica e mallrave do të kërkojnë kontrolle kufitare, veçanërisht nëse nuk do të ketë një marrëveshje tregtare. Qeveria britanike paralajmëroi të mërkurën se deri në 60 për qind e automjeteve të rënda (HGV) mund të mos kenë dokumentet e duhura. "Për këtë shkak ata do të ktheheshin prapa nga



autoritetet kufitare franceze që do ta bllokoni kalimin nga Doveri në Kale. Në rrethana të tilla, kjo mund të çojë në radhë prej 7 mijë automjeteve të rënda në qytetin e Kentit", ka pohuar Michael Gove, ministri që koordinon punët e kabinetit qeveritar.

Tetëdhjetë për qind e ekonomisë britanike i takon sektorit të shërbimeve. Në Londër, bankat dhe shërbimet financiare tashmë janë të përgatitura për mundësinë e mungesës së një marrëveshjeje, thotë autori i raportit Jonathan Portes, i cili punon për programin "Britania në një Evropë që ndryshon", në

kolegjin Kings të Londrës. "Ndaj ata kanë zhvendosur strukturën juridike, disa anëtarë të stafit e të tjerë për t'u përballur me situatën", ka thënë ai.

JP Morgan është banka më e fundit që ka njoftuar një lëvizje të ngjashme këtë javë, zhvendosjen e pronave me vlerë prej 230 miliardë dollarësh nga Londra në Gjermani.

Ekonomia britanike është tkurrur tashmë me një të pestën këtë vit për shkak të pandemisë së koronavirusit. Efektet e vazhdueshme mund ta maskojnë ndikimin e një Brexiti pa marrëveshje duke u

përzierë me njëra-tjetër. "Do të jetë shumë e vështirë të interpretohet se çfarë po ndodh me statistikat ekonomike e të dhënat pasi ndodhemi në këtë periudhë të jashtëzakonshme. Biznesi dhe qeveria janë bllokuar tashmë duke u marrë me pasojat e Covidit", ka deklaruar Portes.

Kufiri në mes të Republikës së Irlandës dhe Irlandës së Veriut do të bëhet një kufi i jashtëm mes Britanisë dhe Bashkimit Evropian. Ekziston frika se çdo kontroll kufijsh këtu mund të shkaktojë një kthim të dhunës sektare.

Marrëveshja e tërheqjes e nënshkruar nga Britania dhe

BE-ja vitin e kaluar, ua hap rrugën kontrolleve kufitare në pjesën e poshtme të detit irlandez në kushtet e mosarritjes së një marrëveshjeje përfundimtare. Por Londra ka miratuar një ligj për ta anashkaluar atë marrëveshjeje, duke shkelur në këtë mënyrë ligjin ndërkombëtar. Kjo ka nxitur shqetësime në Dublin. "Ekziston një ndjesi në rritje se Mbretëria e Bashkuar ndoshta nuk e do një marrëveshjeje. Dhe se kjo ka të bëjë më shumë me menaxhimin e lojës se kush e ka fajin, pasi negociatat të dështojnë", ka theksuar ministri i Jashtëm irlandez Simon Coveney.

Por Britania këmbëngul se e dëshiron ende arritjen e një marrëveshjeje, por të tillë që t'i garantonte asaj sovranitetin. "Ndryshimi kërkon përgatitje. Ndryshimi është ajo për të cilën votuan britanikët", thotë ministri që koordinon punët me kabinetin qeveritar Michael Gove.

Këtë javë kryenegociatori i Bashkimit Evropian, Michel Barnier, ka vizituar Londrën për bisedime jozyrtare përpara një cikli të nëntë negociatash zyrtare që do të mbahen javën e ardhshme. Analistët pohojnë se edhe nëse arrihet marrëveshja, ajo nuk do të jetë gjithëpërfshirëse dhe problemet mund të mos shmangen, pavarësisht rezultatit.

## Nis programi i Akademisë Diplomatike Kombëtare



TIRANË, 25 SHTATOR (ER) - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, ka njoftuar për fillimin e programit të Akademisë Diplomatike Kombëtare.

Ky program synon jo vetëm edukimin e përgjithshëm të diplomatëve të së nesërme, por edhe rritjen e njohurive të diplomatëve për historinë e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Përtej ligjëratave të pasura për historinë e diplomacisë shqiptare që prej orëve të para të shtetit shqiptar, sikurse bën me dije kryediplomati Cakaj, do të ketë edhe shtjellime të hollësishme për politikën e sotme të Shqipërisë në rajon, procesin e integritimit evropian e politikën e Shqipërisë në organizata

shumëpalëshe nga OSBE-ja, NATO e deri te Kombet e Bashkuara.

Prandaj, ky program paraqet një mundësi të vlefshme për të gjithë të rinjtë që mendojnë t'i bashkohen rrugës së diplomacisë, politikës së jashtme e marrëdhënieve ndërkombëtare. "Në frymën e përpjekjeve tona për t'i afruar e bashkuar shqiptarët sa më shumë, ky program do të jetë i hapur edhe për shqiptarët që jetojnë në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi e Serbi. Fillimisht do të veprojmë online, e më pas do të takohemi bashkërisht në Tiranë, për ta mbyllur fazën e parë të programit, në nëntorin e festës kombëtare të flamurit kuq e zi", ka thënë Cakaj.

## Zvicra e heq karantinën për qytetarët nga Kosova

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Zvicra ka marrë vendim që Kosovën ta largojë nga lista e zezë, duke hequr karantinën për qytetarët që kthehen në

shtetin zviceran. Nga 28 shtatori nga lista do të largohet edhe San Marino. Zvicra kishte futur Kosovën në listë për karantinën nga data 6 korrik.

Shteti zviceran ka publikuar listën e re të karantinës ku ka futur edhe disa shtete: Belgjika, Danimarka, Ekuadori, Irlanda, Islanda,

Xhamajka, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Sllovenia, Hungaria, Omani dhe Britania e Madhe.



# Të hënën pritet të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi, asociacioni nuk është në agjendë

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, ka bërë me dije se të hënën do të vazhdojë dialogu në Bruksel. Ai ka treguar se asociacioni i komunave serbe nuk do të jetë pjesë e agjendës

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHTATOR - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, ka konfirmuar se të hënën do të zhvillohet takimi në mes të shefave të ekipeve negociatore të këtyre dy vendeve.

Koordinator shtetëror i Kosovës për dialogun me Serbinë në nivel ekspertësh është Skender Hyseni, kurse pala serbe përfaqësohet nga Marko Gjuriq. Ai ka thënë se temë e diskutimit do të jenë pretendimet financiare dhe ato pronësore. "Tema e asociacionit nuk do të jetë në agjendë pasi njëra palë nuk është e gatshme për të diskutuar, mirëpo kjo gjë duhet të adresohet në kuadër të marrëveshjes gjithëpërfshirëse, siç është arritur pajtueshmëri gjatë takimit të liderëve", ka thënë Lajçak në një shkrim publikuar në rrjetin social "Twitter".

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Avdullah Hoti, në një konferencë për media mbajtur të enjten, ka thënë se marrëveshja për asociacionin e komunave me shumicë serbe është e mbyllur dhe se nuk do të diskutohet më për të. "Kjo temë

nuk diskutohet sepse është mbyllur me marrëveshjen e vitit 2013, pastaj marrëveshja tjetër me parime e vitit 2015 që, në fakt, e përmirëson marrëveshjen e vitit 2013. Pra, kjo nuk është temë që hapet në procesin e dialogut", ka deklaruar Hoti.

Formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe është paraparë me marrëveshjen e parë të Brukselit të vitit 2013, të arritur në dialogun Kosovë - Serbi. Më tutje, detajet konkrete janë harmonizuar me parimet/elementet e përgjithshme nga marrëveshja e vitit 2015. Në tetor të vitit 2015 kjo marrëveshje u dërgua për interpretim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e nxjerrë në dhjetor të vitit 2015, tha se Marrëveshja për Asociacionin në 23 pika të saj nuk është në harmoni me Kushtetutën e Kosovës.

Gjykata kishte konstatuar se asociacioni i komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç ishte paraparë me marrëveshjen e parë të Brukselit (të vitit 2013), të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës



dhe të shpallur nga presidentja e Republikës së Kosovës (v. j. Atifete Jahjaga), kurse marrëveshja mbi parimet (për themelimin e asociacionit, e arritur më 2015), nuk është tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar që akti juridik i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe statuti që implementon parimet, për të

qenë në pajtueshmëri me frymën e Kushtetutës, duhet t'i plotësojë standardet kushtetuese. Në fakt, është e diskutueshme që asociacioni nuk bazohet në multietnicitet, por bashkon komuna në të cilat një komunitet etnik është shumica. Janë gjithsej dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të enjten në një adresim për media ka thënë se Beogradi

është i gatshëm ta vazhdojë dialogun me Kosovën në Bruksel, por theksoi se asociacioni i komunave me shumicë serbe është temë e pashmangshme. Ai këto komente i ka bërë duke u përgjigjur në pyetjen nëse do të vazhdojë dialogu më 28 shtator. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011 në Bruksel.

## ATK-ja dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit shtojnë veprimet për bashkëpunim

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Koordinator Shtetëror për Dialogun me Serbinë, Skender Hyseni, ka vazhduar takimet me ambasadorët e vendeve perëndimore në Kosovë për t'i njoftuar me rrjedhën e deritashme të dialogut Kosovë - Serbi.

Të premten ai ka takuar ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly.

Hyseni ka treguar se me diplomatin zviceran kanë biseduar për rrjedhën e deritashme të dialogut Kosovë - Serbi dhe situatën e përgjithshme në Kosovë. "Me ambasadorin e Zvicrës, Thomas Kolly, gjatë një takimi sot në zyrën time biseduam për rrjedhën e deritashme të

dialogut Kosovë - Serbi dhe situatën e përgjithshme në Kosovë. Çmova lart kontributin e madh të Zvicrës në të gjitha fazat e historisë më të re dhe shtetndërtimit në Kosovë", ka shkruar Hyseni në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka vlerësuar se kontributi i shtetit zviceran në shtetndërtimin e Kosovës ka qenë shumë i rëndësishëm. "Zvicra ka dhënë kontribut të çmueshëm për rindërtimin e Kosovës së pasluftës. Ambasadori Kolly, nga ana e tij, tha se përkushtimi dhe përkrahja e Zvicrës do të vazhdojë dhe se internimi dhe angazhimi në rajon është i përqendruar", ka shkruar Hyseni.





EULEX-I KA BASTISUR TË PREMTEN ZYRAT E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË  
ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK)

# EULEX-i ARRESTON DY UDHËHEQËSIT E OVLUÇK-së, GUCATIN E HARADINAJN

Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka bastisur të premtën zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK). Gjatë këtij aksioni, në të cilin kanë marrë pjesë edhe hetuesit e Gjykatës Speciale, është arrestuar kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, i cili është dërguar për në Hagë. Ndërkaq vetëm dy orë më vonë është arrestuar edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj. Arsyet e arrestimit të tyre nuk janë bërë të ditura. As Gucati dhe as Haradinaj asnjëherë më parë nuk janë intervistuar nga Gjykata Speciale

Avokati i OVLUÇK-së, Tomë Gashi, nuk ka mundur të tregojë nëse arrestimi i Gucati ka të bëjë me dyshimet për krime luftime apo me publikimin e dosjeve të dala nga Specialja, të cilat i ka bërë OVLUÇK-ja gjatë këtij muaji. "Tani u arrestua nga policia e EULEX-it kryetari i OVLUÇK-së, z. Hysni Gucati dhe do të transferohet në Hagë.

Bastisjet po vazhdojnë", ka shkruar Gashi në profilin e vet në "Facebook".

Në këtë aksion kanë marrë pjesë dhjetëra forca speciale të EULEX-it, Policia e Kosovës vetëm pas një kohe ka arritur në vendin e ngjarjes, ku është marrë me mbajtjen e rendit para zyrave të organizatave të dala nga lufta.

Ky është arrestimi i dytë që bëhet nga Specialja.


Një ditë më parë Zyra e Prokurorit të Specializuar ka arrestuar Salih Mustafën (Calin), njërin prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën e Llapit.

EULEX-i edhe në arrestimin e të enjtes i ka dhënë përkrahje operacionale dhe logjistike Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Shoqata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tri herë në javët e fundit ka njoftuar se një person anonim ka dorëzuar tek

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Me urdhër të Gjykatës Speciale, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, është arrestuar të premtën nga pjesëtarë të Misionit Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit (EULEX). Kreu i veteranëve është arrestuar gjatë një aksioni të këtij misioni për bastisjen e zyrave të kësaj organizate në Prishtinë. Pas disa orë bastisjes,

ku kanë marrë pjesë edhe hetuesit e Gjykatës Speciale, Gucati është parë duke dalë i prangosur nga zyrat e OVLUÇK-së dhe duke hyrë në veturën e EULEX-it. Ky arrestim ka nxitur tensione. Qytetarët dhe veteranët që ishin mbledhur para zyrave të OVLUÇK-së kanë nisur të hedhin shishe në drejtim të zyrtarëve të EULEX-it pas arrestimit të Hysni Gucati. Ndërkaq vetëm dy orë më vonë është arrestuar edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj.





Visar Kryezli (AP)

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë për qëllim ta minojnë administrimin e drejtësisë në mënyrë të duhur.

### Veteranët paralajmërojnë kundërpërgjigje ndaj aksionit të EULEX-it

Përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta kanë kundërshtuar aksionin e EULEX-it për t'i bastisur zyrat e tyre pa paralajmërim. Ata këto veprime i kanë krahasuar me ato të ish-Jugosllavisë. Teksa zhvillohej aksioni për bastisje, sekretari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Faton Klinaku, ka thënë para mediave se këto veprime do t'i detyrojnë të reagojnë sikurse kanë bërë gjatë ish-Jugosllavisë. "Isha në zyrë duke pirë kafe dhe këta zotërinjtë nuk prezantojnë asnjë letër. Iu thash edhe Jugosllavia ka bërë kështu dhe jemi detyruar t'i përgjigjemi. Nëse shteti ynë s'merr masa, këta do të na detyrojnë të luftojmë edhe sikur kundër Jugosllavisë. As s'kanë dokumente, as letra, as përkthyes. Shteti ynë i ka fajet. Është bastisje. S'ka arrestime", ka thënë ai, duke i quajtur kriminelë zyrtarët e EULEX-it. Edhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka kritikuar aksionin e EULEX-it. Ai ka thënë se institucioneve të Kosovës duhet t'u vijë turp që lejojnë gjëra të tilla.



ajo mijëra dosje që përmbajnë emrat dhe adresat e dëshmitarëve. Këto dokumente, sipas saj, janë të Gjykatës Speciale. Pas çdo dorëzimi udhëheqësit e Shoqatës kanë mbajtur konferencë për media, ku gazetarëve u është lejuar t'i marrin ato dokumente. Pas çdo konference, dokumentet janë konfiskuar nga hetuesit në Hagë. Përmbajtja e tyre është e panjohur dhe ende nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike. Në fillim të javës, Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka thënë se disa aktivitete në të cilat është përfshirë



Jashari ka thënë se nuk do të lejojnë veprime të tilla pa paralajmërim. "Ne nuk do të lejojmë që të vijnë pa asnjë urdhëresë dhe pa paralajmërim. Mund të jenë edhe kriminelë të Serbisë. Janë të maskuar, flasin gjuhë të ndryshme, një pjesë flasin sllavisht. Ne nuk do të lejojmë gjëra të tilla. Lirinë e kemi fituar me luftë dhe gjak dhe nuk lejojmë të na marrin", ka thënë ai.

### Haradinaj: S'ka arsye për operacione dhe bastisje, secili do t'i përgjigjet vullnetarisht drejtësisë

Aksioni i EULEX-it ka ngjallur reagime të ndryshme. Ndër të parët që ka reaguar ka qenë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka deklaruar edhe një herë se publikimi i dosjeve të Gjykatës Speciale ka qenë i gabuar. "E ritheksoj qëndrimin tim, se publikimi i

dosjeve të Gjykatës Speciale ka qenë i gabuar dhe se do ta dëmtojë më së shumti shtetin tonë, përfshirë edhe vetë të akuzuarit. Tentimi për ta krijuar imazhin, se Kosova është e mobilizuar ta pengojë drejtësinë, është i gabuar. Ne nuk kemi qenë e as nuk jemi në anën e kundërt të drejtësisë. Apeloj tek organet e drejtësisë, vendore dhe ndërkombëtare, që t'i respektojnë të drejtat e të gjithëve. Asnjë i akuzuar nuk do t'i ikë drejtësisë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Ai ka deklaruar se

nuk ka arsye për operacione e bastisje, duke shtuar se secili qytetar do t'i përgjigjet drejtësisë. "Konsideroj se nuk ka arsye për operacione e bastisje, sepse secili do t'i përgjigjet vullnetarisht drejtësisë. Kosova është gjithmonë me ligjin dhe me viktimat, sepse vetë ishte viktimë e padrejtësisë. Vetë UÇK-ja dhe populli i Kosovës kanë argumentuar se gjithmonë janë pozicionuar në anën e drejtësisë, të vërtetës dhe të drejtës ndërkombëtare. Kjo nuk ka ndryshuar asnjëherë", ka shkruar Haradinaj.

## KMDLNj: Gucatit nuk ia treguan arsyet e arrestimit

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas aksionit të EULEX-it në zyrat e organizatave të dala nga lufta dhe arrestimin e Hysni Gucatit, kryetar i OVLUÇK-së. Përmes një komunikate për media, KMDLNj ka vlerësuar se arrestimi i Gucatit u bë pa ia treguar arsyet e arrestimit. "Me urdhër të Gjykatës Speciale në Hagë, policë të EULEX-it dje arrestuan Salih Mustafën - 'Calin' pasi, siç u deklarua kjo Gjykatë, më vonë ndaj tij ishte konfirmuar aktakuza nga gjykatësi i caktuar po nga kjo Gjykatë. Gjatë tërë procesit, autoritetet

vendore ishin përjashtuar krejtësisht nga operacioni i arrestimit sikur edhe gjatë ndërhyrjeve të përditshme në zyrat e OVL-së së UÇK-së nga persona të panjohur, me rroba civile kurse sot, një numër i madh i policëve të EULEX-it, të armatosur rëndë bastisën këto zyra sikur që arrestuan kryetarin Hysni Gucati, pa dhënë, së paku deri më tani, arsyet e arrestimit", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së. Gjatë këtij aksioni, sipas këtij këshilli, policët kanë penguar edhe gazetarët duke mos i lejuar ta bëjnë punën për çka edhe janë të thirrur.



# Betohen kadetët e rinj të FSK-së



Të premtën në ambientet e kazermës "Adem Jashari" është mbajtur ceremonia ushtarake e betimit të kadetëve studentë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2020-2024

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të premtën është mbajtur ceremonia ushtarake e betimit të kadetëve studentë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2020-2024.

Në ceremoninë e organizuar me pjesëmarrje të kufizuara për shkak të masave kundër Covid-19, morën pjesë zëvendësministria e Mbrojtjes,

Sadika Kofrc, zëvendësministri i Mbrojtjes, Muhametalli Mergjollar, komandanti i FSK-së, gjeneralletenanti Rahman Rama, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Frank Best, stafi tjetër i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarakë bilateralë, si dhe familjarë të kadetëve studentë të rinj.

Me protokollin e ceremonisë ushtarake, me fjalë përshëndetëse dhe mesazhe

urimi, kadetëve studentë të rreshtuar, stafit drejtues dhe akademik të QSU-së dhe të pranishmëve të tjerë, iu drejtua nikoqiri i ceremonisë, zëvendëskomandanti i QSU-së, kapiten Lirim Bllaca dhe gjeneral Rama, kurse për shkak të angazhimeve të tjera jashtë vendit, u lexua letra përshëndetëse me mesazhe urimi e dërguar nga ministri i Mbrojtjes, Anton Quni.

Në fjalën e tij, gjeneral Rama, përveç urimeve, theksoi se rrugëtimi i nisur për ta realizuar arritjen e standardeve

më të larta profesionale dhe akademike do të realizohet me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. "Sot ju do të betoheni para flamurit, prindërve dhe udhëheqësve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: Detyra, nderi, atdheu", ka thënë ai.

Gjeneral Rama vlerësoi lart të arriturat e QSU-së për 15 vjet më radhë në funksion të ndërtimit të forcave moderne,

profesionale, shumetnike, të disiplinuar dhe të trajnuar sipas standardeve të ushtrive perëndimore së bashku me partnerët tanë strategjikë.

Ndër të tjera, kadetët e rinj i inkurajoi që ta sfidojnë vetveten sa më shumë dhe ta mbrojnë njëri-tjetrin. Me letër urimi, drejtuar kadetëve studentë të rinj, ministri Quni çmoi shumë lart ata, duke i vlerësuar si "e tashmja dhe e ardhmja e forcave tona". Ai kërkoi nga ta përkushtim të madh gjatë studimeve duke këshilluar që shpirti patriotik t'i udhëheqë vlerat e moralit, ndërsa profesionalizmi të jetë qëllimi më i lartë gjatë studimeve katërvjeçare. "Si ministër i Mbrojtjes besoj se me suksesin më të lartë do ta realizoni planin mësimor dhe praktik të paraparë dhe me njohuritë e arritura në të ardhmen do të jeni oficerë të NATO-s dhe krah për krah me kolegët e juaj nga ushtri të vendeve anëtare të Aleancës, do ta jepni kontributin tuaj në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo që është e nevojshme", ka thënë ministri Quni.

Ceremonia përkatëse u organizua me fillimin e vitit akademik 2020/21 të QSU-së për gjeneratën 24 të saj me 16 kadetët studentë të cilët do t'i ndjekin studimet e rregullta katërvjeçare sipas planprogrameve mësimore me module teorike dhe praktike sipas standardeve të akademike më të avancuara ushtarake perëndimore e veçanërisht ShBA-së.

## Vazhdon aksioni i policisë për shkatërrimin e bimëve narkotike



PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës në vazhden e implementimit të planit operativ "Parandalimi i kultivimit të narkotikëve dhe kontrabandës" ka bërë identifikimin dhe shkatërrimin e disa bimëve narkotike.

Të premtën në rajonin e Koshares, Policia e Kosovës gjatë zbatimit të planit

operativ, në orët e para të mëngjesit ka zbuluar edhe një plantacion me të mbjella në sasi prej 212 (dyqind e dymbëdhjetë) bimë narkotike të llojit "Canabis Sativa", me gjatësi nga një deri në tri metra. Në lidhje me rastin janë njoftuar të gjitha njësitë relevante të policisë si dhe prokurori i Prokurorisë Themelore në

Gjakovë.

Pas marrjes së mostrave, me urdhër të prokurorit kompetent të gjitha bimët narkotike janë shkatërruar (djegur) në vendin e ngjarjes. Policia e Kosovës ka njoftuar se do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në luftimin dhe parandalimin e të gjitha dukurive negative që bien ndesh me ligjin.

## Vazhdon aksioni i policisë për shkatërrimin e bimëve narkotike

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës në vazhden e implementimit të planit operativ "Parandalimi i kultivimit të narkotikëve dhe kontrabandës" ka bërë identifikimin dhe shkatërrimin e disa bimëve narkotike.

Të premtën në rajonin e Koshares, Policia e Kosovës gjatë zbatimit të planit opera-

tiv, në orët e para të mëngjesit ka zbuluar edhe një plantacion me të mbjella në sasi prej 212 (dyqind e dymbëdhjetë) bimë narkotike të llojit "Canabis Sativa", me gjatësi nga një deri në tri metra. Në lidhje me rastin janë njoftuar të gjitha njësitë relevante të policisë si dhe prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Pas marrjes së mostrave, me urdhër të prokurorit kompetent të gjitha bimët narkotike janë shkatërruar (djegur) në vendin e ngjarjes.

Policia e Kosovës ka njoftuar se do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në luftimin dhe parandalimin e të gjitha dukurive negative që bien ndesh me ligjin.



Një i vdekur dhe 46 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit në Kosovë

## Ministri Zemaj paralajmëron lehtësim të masave

Një i vdekur dhe 46 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan të premten në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se rastet e reja pozitive rezultojnë nga testimi i 664 mostrave. Në njoftim, po ashtu, thuhet se në 24 orët e fundit 101 pacientë janë shëruar nga Covidi. Duke iu referuar situatës së fundit me Covid, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar lehtësim të masave

Ferizaj dhe Malishevë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se nga testimet e bëra, në 24 orët e fundit sërish ka rezultate të kënaqshme, pasi vetëm 46 raste kanë rezultuar pozitiv me Covid-19.

Zemaj ka thënë se kultura qytetare, respektimi i masave dhe rekomandimet e vendosura prej Ministrisë së Shëndetësisë, me rekomandim të IKShPK-së, si dhe koordinimi i plotë me të gjithë aktorët e tjerë, po sjell rezultate të kënaqshme. "Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit pozitive dhe trendin e rënies së lakores të rasteve të infektiveve, në mbledhjen e qeverisë do të propozojë lehtësimin e masave, por duke mbetur të gjithë të përkushtuar dhe vigjilentë", ka

thënë ai. Zemaj ka theksuar se veprimi i përbashkët me të gjitha nivelet e shëndetësisë, me pushtetin lokal dhe të gjithë aktorët relevantë për zbatimin e masave anti covid, sollën edhe rezultate të mira edhe propozimin e lehtësirave të këtyre masave. "Së bashku, do t'i zbatojmë edhe masat lehtësuese, sepse vetëm ashtu mund të kemi sukses. Faleminderit qytetarëve dhe të gjitha institucioneve të përfshira për arritjen e përbashkët! Mosrespektimi i rekomandimeve për masat lehtësuese do të sjellë vendime adekuate me gjendjen e krijuar. Por, kam besim të plotë, sikur deri sot, të respektohen vendimet dhe përkushtimin kundër virusit Covid-19", ka deklaruar ministri Zemaj.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 664 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve

në terren, prej të cilëve rezultojnë 46 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid-19. Numri total i rasteve pozitive është 15 379 raste nga 64 894 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 617 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 101 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 13 088 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 674.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 15 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Mitrovicë 5 raste, komuna Podujevë 4 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Gjilan 2 raste, komuna Pejë 2 raste, komuna Vushtri 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas,



## Hoti mirëpret propozimin e Grenellit që Liqeni i Ujmanit të quhet 'Liqeni Trump'

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Bashkuara Amerikës, si: Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ka mirëpritur propozimin e të dërguarit të Shtëpisë së Bardhë për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, që Liqeni i Ujmanit të quhet Liqeni Trump. Ai ka thënë se kjo gjë mund të bëhet "në shenjë nderimi për rolin e tij të jashtëzakonshëm për arritjen e marrëveshjes historike për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë". "Në shenjë nderimi për rolin e tyre vendimtar për lirinë, pavarësinë dhe njohjen e shtetësisë së Republikës sonë anekënd botës, ne i kemi pagëzuar sheshet më të bukura të qyteteve tona me emrat e personaliteteve më të shquara të Shteteve të

Bashkuara Amerikës, si: Presidenti Klinton, Xhorxh Bush, Senatori Bob Dol, Sekretarja Medlin Olbrajt etj", ka thënë Hoti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Komenti i tij ka ardhur pasi Grenelli ka thënë se si pala e Kosovës, ashtu edhe ajo serbe janë pajtuar që Liqeni i Ujmanit ta ketë emrin Liqeni Trump. "Si të quhet liqeni që është në Kosovë dhe Serbi, ka qenë çështje serioze, pavarësisht prej kompromisit të krijuar nga Shtetet e Bashkuara për të nisur një studim fizibiliteti për të krijuar më shumë vende pune dhe energji në rajon... andaj të dyja palët janë pajtuar për një emër të ri: Liqeni Trump", ka thënë Grenell, përmes një postimi në rrjetin social "Twitter".



Courtesy Photo

Një i vdekur dhe 46 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit në Kosovë

## Ministri Zemaj paralajmëron lehtësim të masave

Një i vdekur dhe 46 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan të premten në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se rastet e reja pozitive rezultojnë nga testimi i 664 mostrave. Në njoftim, po ashtu, thuhet se në 24 orët e fundit 101 pacientë janë shëruar nga Covidi. Duke iu referuar situatës së fundit me Covid, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar lehtësim të masave

Ferizaj dhe Malishevë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se nga testimet e bëra, në 24 orët e fundit sërish ka rezultate të kënaqshme, pasi vetëm 46 raste kanë rezultuar pozitiv me Covid-19.

Zemaj ka thënë se kultura qytetare, respektimi i masave dhe rekomandimet e vendosura prej Ministrisë së Shëndetësisë, me rekomandim të IKShPK-së, si dhe koordinimi i plotë me të gjithë aktorët e tjerë, po sjell rezultate të kënaqshme. "Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit pozitive dhe trendin e rënies së lakores të rasteve të infektiveve, në mbledhjen e qeverisë do të propozojë lehtësimin e masave, por duke mbetur të gjithë të përkushtuar dhe vigjilentë", ka

thënë ai. Zemaj ka theksuar se veprimi i përbashkët me të gjitha nivelet e shëndetësisë, me pushtetin lokal dhe të gjithë aktorët relevantë për zbatimin e masave anti covid, sollën edhe rezultate të mira edhe propozimin e lehtësirave të këtyre masave. "Së bashku, do t'i zbatojmë edhe masat lehtësuese, sepse vetëm ashtu mund të kemi sukses. Faleminderit qytetarëve dhe të gjitha institucioneve të përfshira për arritjen e përbashkët! Mosrespektimi i rekomandimeve për masat lehtësuese do të sjellë vendime adekuate me gjendjen e krijuar. Por, kam besim të plotë, sikur deri sot, të respektohen vendimet dhe përkushtimin kundër virusit Covid-19", ka deklaruar ministri Zemaj.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 664 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve

në terren, prej të cilëve rezultojnë 46 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid-19. Numri total i rasteve pozitive është 15 379 raste nga 64 894 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 617 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 101 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 13 088 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 674.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 15 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Mitrovicë 5 raste, komuna Podujevë 4 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Gjilan 2 raste, komuna Pejë 2 raste, komuna Vushtri 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas,



## Hoti mirëpret propozimin e Grenellit që Liqeni i Ujmanit të quhet 'Liqeni Trump'

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Bashkuara Amerikës, si: Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ka mirëpritur propozimin e të dërguarit të Shtëpisë së Bardhë për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, që Liqeni i Ujmanit të quhet Liqeni Trump. Ai ka thënë se kjo gjë mund të bëhet "në shenjë nderimi për rolin e tij të jashtëzakonshëm për arritjen e marrëveshjes historike për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë". "Në shenjë nderimi për rolin e tyre vendimtar për lirinë, pavarësinë dhe njohjen e shtetësisë së Republikës sonë anekënd botës, ne i kemi pagëzuar sheshet më të bukura të qyteteve tona me emrat e personaliteteve më të shquara të Shteteve të

Bashkuara Amerikës, si: Presidenti Klinton, Xhorxh Bush, Senatori Bob Dol, Sekretarja Medlin Olbrajt etj", ka thënë Hoti përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Komenti i tij ka ardhur pasi Grenelli ka thënë se si pala e Kosovës, ashtu edhe ajo serbe janë pajtuar që Liqeni i Ujmanit ta ketë emrin Liqeni Trump. "Si të quhet liqeni që është në Kosovë dhe Serbi, ka qenë çështje serioze, pavarësisht prej kompromisit të krijuar nga Shtetet e Bashkuara për të nisur një studim fizibiliteti për të krijuar më shumë vende pune dhe energji në rajon... andaj të dyja palët janë pajtuar për një emër të ri: Liqeni Trump", ka thënë Grenell, përmes një postimi në rrjetin social "Twitter".



Courtesy Photo





# Dështon sërish votimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19

Edhe në seancën e së premtes të Kuvendit të Kosovës ka dështuar të votohet Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike. Për këtë projektligj nuk pati kuorum në Kuvendin e Kosovës, pasi për të votuan vetëm 60 deputetë. Për të kaluar ky projektligj duheshin 61 vota. Kjo është hera e tretë që dështon ky projektligj në Kuvendin e Kosovës. Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për seancën e ardhshme

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës ka dështuar për herë të tretë ta votojë në lexim të parë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19. Për këtë projektligj nuk pati kuorum në Kuvendin e Kosovës, pasi për të votuan vetëm 60 deputetë. Gjatë seancës, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka kërkuar nga deputetët që ta votojnë këtë projektligj, sepse vetëm në këtë mënyrë mundësohet zbatimi i fondit për ndihmë ndaj bizneseve. "Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike ka në vete disa nene, të cilat e bëjnë të mundshme zbatimin e qeverisë për rimëkëmbje ekonomike. Përveç 10-përqindëshit nga Trusti i Kursimeve Pensionale, është edhe kapitalizimi i Fondit për

garantimin e kredive deri në 100 milionë, mbulimi i kamatave për të gjitha bizneset që do të marrin kredi, mundësi që edhe fermat e vogla të marrin kredi", ka thënë Bajrami. Partia Demokratike e Kosovës nuk e përkrah këtë projektligj pasi, sipas saj, ligji nuk sjell përfitime për të gjitha kategoritë. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se "nëse janë në pyetje vetëm mjetet e Trustit të Kursimeve Pensionale, mund të ndryshohet Ligji për Fondet Pensionale". "Amendamenti i këtij Ligji për Fondet Pensionale, me një nen dhe kjo punë kryhet dhe i njëjti të trajtohet në të njëjtën ditë, brenda dy seancave dhe të përfundohet. Mirëpo të thuhet se është Projektligj për Rimëkëmbje Ekonomike dhe, faktikisht, nuk ka përkrahje

domethënëse, nuk them se nuk ka asgjë, por nuk ka përkrahje domethënëse për sektorin privat, për të punësuarit në sektorin privat dhe për kategoritë e tjera të cilat janë në nevojë, ne e kemi problem", ka thënë Hamza. Në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati ka thënë se nuk është hera e parë që Lidhja Demokratike e Kosovës ka tentuar t'i fusë duart në Trust sepse Trusti është çështja kryesore që po flitet në këtë projektligj. "Tashmë e kemi rastin tjetër, ku po tentohet që të hapet dera fillimisht, duke u thënë qytetarëve se do të marrin nga 10 për qind të mjeteve të kursyera. Por, unë i garantoj qytetarët se kjo nuk do të përfundojë këtu. Shumë shpejt do të ndodhë që prapë do të na sjellin edhe një ligj tjetër sa herë që qeveria nuk

mund t'i kryejë punët e veta, sikur po ndodh tani, edhe të thuhet që t'ua mundësojmë qytetarëve edhe 10 për qind, ndoshta edhe 10 për qind me ia dhënë qeverisë. Pra, vetë qeveria me i marrë paratë e kursimeve", u shpreh Murati. Votimi i këtij projektligji do t'ua mundësonte qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Deri më tani vlera e mjeteve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës ka arritur në mbi 2 miliardë euro me rreth 690 mijë kontributpagues. Kjo i bie se vlera e përgjithshme që do të mund të tërhiqej nga Fondi është rreth 200 milionë euro, mjete këto që, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, janë konsideruar se do ta stimulonin kërkesën agregate në treg. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike, që më 22 korrik u miratua në Qeverinë e Kosovës, kap vlerën prej 385 milionë eurove. Ky projektligj synon që përmes politikave fiskale dhe monetare t'iu ndihmojë bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.

**OEK DHE OEAK U KËRKOJNË DEPUTETËVE QË TË ARRIJNË KONSSENSUS PËR LEGJISLACIONIN PËR RIMËKËMBJE**

Para fillimit të seancës së Kuvendit, edhe subjektet ekonomike në Kosovë, Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës kanë kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të arrijnë konsensus për legjislacionin për rimëkëmbje. Shumica e bizneseve në Kosovë, gati në të gjithë sektorët, kanë raportuar vlera të mëdha të humbjeve financiare dhe zvogëlim të kapaciteteve prodhuese, nga masat e marra nga qeveria më 13 mars për parandalimin e pandemisë. "Janë bërë gjashtë muaj nga vendosja e masave të para kufizuese me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19 të cilat kanë shkaktuar ndërprerje të paprecedentë të aktiviteteve

ekonomike dhe rrjedhimisht vështirësi të mëdha në operimin e ndërmarrjeve të të gjitha industrive në Kosovë. Derisa reagimi institucional në fazën emergjente ishte i mangët dhe i vonuar, shumë ndërmarrje vazhdojnë të ballafaqohen me kërcënim serioz në aspektin e mbijetesës dhe ruajtjes së vendeve të punës”, thuhet në deklaratën e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Këto dy oda ekonomike u kanë bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që, duke u bazuar në nevojën e bizneseve për veprim të shpejtë për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike, ta arrijnë konsensusin e nevojshëm që do ta mundësonte krijimin e legjislacionit përkatës për zbatimin e këtyre masave. Duke qenë të vetëdijshëm që përmbajtja e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka nevojë për plotësim të mëtejshëm me dispozita të tjera që adresojnë vështirësitë e sektorit privat, në fazën

aktuale, por edhe në fazë afatgjatë, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane u kërkojnë deputetëve që në seancën e sotme të aprovojnë në lexim të parë projektligjin e proceduar nga ekzekutivi, duke hapur mundësinë e plotësimin të mëtejshëm të tij deri në leximin përfundimtar. Veprimi i shpejtë i përcjellë me masa që adresojnë në mënyrë proporcionale dëmin e shkaktuar në ekonomi, është thelbësor për shpëtimin e ndërmarrjeve dhe punonjësve të goditur nga pandemia Covid-19, si dhe përmbajtja e thellimit të vështirësive ekonomiko-sociale, në një kohë kur vendet e tjera janë shumë para Republikës së Kosovës në aspekt të ndërhyrjes shtetërore me qëllim të drejtimit dhe zbatimit të programeve të rimëkëmbjes ekonomike. Në të kundërtën, situata ekonomike dhe sociale do të vijojë të bëhet edhe më e rëndë”, thuhet në deklaratën e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.



## Hoti diskuton për projektet kapitale me përfaqësuesit e DFC-së

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe ministri i Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës, Arban Abrashi, janë takuar në Prishtinë me përfaqësuesit e Korporatës Financiare të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (DFC), Caleb McCarry, Brian Martalus dhe John Jovanović, për të diskutuar rreth zbatimit të projekteve të parapara me marrëveshjen për normalizim ekonomik mes Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë. Pjesë e këtij takimi të enjten ka qenë edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett. “Gjatë këtij takimi

diskutimi u përqendrua në fusha të veçanta, respektivisht në projektet kapitale, si: autostrada, hekurudha dhe energjia”, është cituar të ketë thënë Hoti në një komunikatë për media. Kryeministri Hoti ka thënë se Kosova dhe institucionet e saj duhet ta shfrytëzojnë momentumin e ri të krijuar pas nënshkrimit të marrëveshjes në Uashington. Sipas tij, Kosova për pesë vjet do të kthehet në një zonë të gjallëruar me shumë vende pune. Më herët gjatë kësaj jave përfaqësues të DFC-së kanë nënshkruar marrëveshje me përfaqësues nga Kosova dhe Serbia për zbatim të pikave që parashihen në marrëveshjen e

4 shtatorit. Mes të tjerash, DFC ka hapur edhe zyrën e saj të parë rajonale në Beograd. Kryeministri Hoti dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq kanë nënshkruar marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, në praninë e presidentit Trump. Të dyja palët, megjithatë, nuk i kanë hedhur nënshkrimet në dokumentin e njëjtë, por secila veç e veç i ka nënshkruar zotimet e saj. Trumpi, në anën tjetër, ka nënshkruar një letër, përmes së cilës i ka përgëzuar palët për guxim drejt normalizimit të marrëdhënieve.



## Bordi i Përkohshëm dhe aksionari vlerësojnë lart performancën e KEK-ut

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Me autorizimin e lëshuar nga Blerim Kuqi, ministër i Ekonomisë dhe Ambientit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në Korporatën Energjetike të Kosovës KEK sh.a. është mbajtur mbledhja e përgjithshme vjetore e aksionarit. “Kjo mbledhje përbën takimin më të rëndësishëm të korporatës në të cilin shqyrtohen dhe miratohen dokumente të rëndësishme dhe strategjike për ndërmarrjen. Në këtë takim janë miratuar raporti i auditorit të pavarur për pasqyrat financiare në fundvit 2019 dhe letrës së menaxhmentit si dhe raporti vjetor 2019. Po ashtu, u shqyrtua performanca e menaxhmentit për periudhën e njëjtë”, ka njoftuar KEK-u. Për më tepër, aksionari ka vlerësuar faktin se korporata



edhe këtë vit, si tash e disa vite, pranon një raport të auditorit pa kualifikime, ndërsa që u përsërit kërkesa për adresim të

çështjeve të theksuara në raport. Bordi i Përkohshëm dhe përfaqësuesit e aksionarit u

zotuan për mbështetje të vazhdueshme të menaxhmentit por, njëkohësisht, kërkuan shtim të përpjekjeve për

tejkallim të pengesave dhe vështirësive aktuale dhe vazhdimin e trendit të performancës së mirë.

## Siguria e qytetarëve dhe mbrojtja e mjedisit, fokus në Komunën e Skenderajt

SKENDERAJ, 25 SHTATOR (ER) - Nga dita e premte në Komunën e Skenderajt të gjithë ata që shkelin ligjin duke bërë vepra penale, duke dëmtuar e ndotur hapësirat publike dhe mjedisin në përgjithësi, do të identifikohen nga policia përmes kamerave të sigurisë dhe do të dënohen sipas legjislacionit në fuq. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin

Nuredin Lushtaku, drejtorët komunalë si dhe me komandantin e Stacionit Policor në Skenderaj, Basri Durmishi, kanë përfunduar sistemin e sigurisë përmes instalimit të kamerave në 40 lokacione në qytetin e Skenderajt. Kryetari Jashari bëri me dije se nga sot lëvizjet në Skenderaj do të vëzhgohen 24 orë në ditë nga policia përmes këtyre kamerave. Ndërsa komandanti i Stacionit Policor

në Skenderaj, Basri Durmishi, ka falënderuar kryetarin Jashari si dhe komunën për këtë projekt, duke thënë se këto kamera do ta ndihmojnë policinë në punën e saj. Sipas statistikave zyrtare të Policisë së Kosovës, vitet e fundit është shënuar rënie drastike e incidenteve dhe kështu, me instalimin e këtyre kamerave, do të arrihen edhe më shumë rezultate pozitive për rritjen e nivelit të sigurisë së qytetarëve të Skenderajt.



## Nënkryetari i Podujevës vizitoi vullnetarët e organizatës PEN



PODUJEVË, 25 SHTATOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka vizituar vullnetarët e organizatës PEN të cilët me mbështetjen e UNICEF-it dhe Ambasadës së Japonisë në Kosovë po zhvillojnë

kampanjë vetëdijësuese "skamalehte" me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve të Podujevës për respektimin e rregullave për mbrojtje nga Covid-19. Nënkryetari Rudari u shpreh i lumtur për punën që po e

bëjnë të rinjtë e kësaj organizate. Këtë projekt të vullnetarëve nënkryetari Rudari e ka mbështetur që nga fillimi dhe ka premtuar se do të vazhdojë t'i mbështesë vullnetarët e PEN-it edhe në iniciativat e tjera.

## Ismajli: Ka rënie të madhe të infeksionit me Covid-19 në Gjilan

GJILAN, 25 SHTATOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka deklaruar se në këtë komunë ka rënie të madhe të infeksionit me virusin Covid-19. Në mbledhjen e komitetit për parandalimin e përhapjes së Covid-19, Ismajli ka

thënë tashmë në Gjilan ka vetëm 69 raste aktive me virusin korona. Pasqyra e përgjithshme e përballjes me pandeminë Covid-19 është si vijon: 996 të infektuar në total, 886 të shëruar, 69 raste aktive, 16 të hospitalizuar dhe 44 të vdekur.



## Filloi asfaltimi i rrugës që lidh dy pjesët e fshatit Carrallukë në Malishevë

MALISHEVË, 25 SHTATOR (ER) - Ka filluar asfaltimi, përkatësisht vendosja e shtresës së parë të asfaltit, për rrugën e gjatë 1 400 metra, e cila lidh dy pjesët e fshatit Carrallukë të Komunës së Malishevës. Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge ishin të pranishëm, i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët ishin të shoqëruar nga kryetari i fshatit Carrallukë, Rustem Hoti. Kryetari i Komunës së



Malishevës, Ragip Begaj, pasi është informuar nga mbikëqyrësit dhe operatori për punën që po kryhet, i ka uruar

banorët e fshatit Carrallukë për asfaltimin e kësaj rruge, e cila lidh të dyja pjesët e fshatit dhe shkurton rrugën për disa

kilometra, për të shkuar nga njëra anë në tjetrën.

Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, ka sqaruar se kjo rrugë që po asfaltohet ka një gjatësi prej 1 400 (një mijë e katërqind) metrash dhe hapja, zgjerimi dhe asfaltimi i kësaj rruge është bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit (MIT). Rruga është ndërtuar sipas standardeve, me dy shtresa të asfaltit, me gjerësi 5 metra dhe ka një gjatësi prej 1.4 kilometër.

Kryetari i fshatit Carrallukë, Rustem Hoti, në emër të fshatit i ka falënderuar ministrinë përkatëse dhe Komunën e Malishevës për asfaltimin e kësaj rruge, e cila ka rëndësi të jashtëzakonshme për të gjithë banorët e fshatit sepse përmes saj banorët nuk kanë nevojë të udhëtojnë disa kilometra për të shkuar nga njëra pjesë në tjetrën. Po sipas tij, kjo rrugë, përveç Carrallukës, lidh edhe fshatrat e tjerë dhe shkurton rrugën në masë të madhe.

## Mbyllen edhe tri lokale me dyshimin për veprimtari devijuese

Ferizaj, 25 shtator (ER) - Inspektorati i komunës, bashkë me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Ferizaj, kanë mbyllur

edhe tri lokale në qendër të qytetit, me dyshimin për ushtrimin e veprimtarive devijuese, mungesën e doku-

mentacionit dhe kushteve higjieno-sanitare. Mbyllja e këtyre lokaleve po bëhet tash e disa ditë nga inspektorati i

komunës dhe policia, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, ngre në 21 numrin e lokaleve të mbyllura me këtë motiv.



# Republikanët sigurojnë votuesit amerikanë për tranzicion paqësor të pushtetit

WASHINGTON, 25 SHTATOR - Republikanët kanë reaguar me vendosmëri ndaj refuzimit të presidentit amerikan Donald Trump për t'u deklaruar rreth transferimit të pushtetit në mënyrë paqësore pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, duke siguruar amerikanët se ligjvënësit do ta pranojnë rezultatin.

Trump ka refuzuar të deklarohet nëse do ta dorëzojë paqësisht pushtetin në rast se humb zgjedhjet, në një konferencë për media në Shtëpinë e Bardhë. Teksa është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Trump ka thënë se pret që rezultati zgjedhor të caktohet nga Gjykata Supreme. "Neve na duhet të presim se çfarë do të ndodhë. Do ta

shohim", ka thënë presidenti amerikan kur është pyetur nëse zgjedhjet do të jenë legjitime nëse vetëm ai është fitues.

Trumpi ka thënë se dëshiron "të sigurohet se zgjedhjet janë të sinqerta, por nuk jam i sigurt se ashtu do të jenë". Këto komente të presidentit amerikan më 23 shtator, kanë nxitur reagime nga të dyja partitë.

Shumë senatorë republikanë, bashkë me disa deklarata të Shtëpisë së Bardhë, kanë tentuar t'i sigurojnë votuesit se do të ketë transferim paqësor të pushtetit siç përcaktohet me kushtetutën amerikane. Demokratët, në anën tjetër, kanë kritikuar Trumpin dhe kanë thënë se ai nuk mund ta injorojë votën e njerëzve.



## Ndryshimet klimatike 'po nxisin zjarret në Kaliforni'

NJU JORK, 25 SHTATOR - Ndryshimet klimatike janë duke nxitur shkallën dhe ndikimin e zjarreve që kanë përfshirë së fundmi Kaliforninë, kanë thënë shkencëtarët.

Autorët e hulumtimit kanë gjetur se Kalifornia tani përballet më shumë me rrezikun e zjarreve sesa para kohës kur njerëzit kanë nisur ta ndryshojnë klimën.

Prej muajit gusht ky vend po përballet me zjarret më të mëdha në 18 vjetët e fundit.

Ato kanë qenë përgjegjëse për më shumë se 30 vdekje dhe kanë shtyrë mijëra persona që të



largohen nga shtëpitë e tyre.

Shkaku i zjarreve është kthyer në çështje politike, pasi guvernatori i Kalifornisë, Gavin Newsom, ka vënë fajin te ndryshimet klimatike për zjarret në fjalë.

Presidenti amerikan Donald Trump, në anën tjetër, ka hedhur poshtë këtë argument, duke përmendur praktikën e menaxhimit të tokave të atij territori. Mirëpo një kërkim shkencor, i drejtuar nga profesori Matthew Jones, për arsyt e këtyre zjarreve, sugjeron se rritja e temperaturave është duke pasur ndikim të madh.

Më herët, gjatë këtij viti, ekipi i

njëjtë hulumtues ka publikuar një analizë për origjinën e zjarreve dramatike që kanë përfshirë Australinë në periudhën 2019-2020. Studimi ka treguar se ndryshimet klimatike qëndrojnë mbrapa rritjes së sezonit të zjarreve, e definuar si periudhë me rrezik më të lartë të zjarreve për shkak të kombinimit të temperaturave të larta, lagështisë së ulët, erërave të forta dhe reshjeve të pakta.

Brenda 40 vjetëve, përkatësisht në periudhën 1979-2019, periudha e zjarreve është thënë të jetë zgjatuar për tetë ditë në nivel global.

## Karnavali i Rios shtyhet për afat të pacaktuar

RIO, 25 SHTATOR - Pandemia me koronavirus ka shtuar një tjetër viktimë në listën e gjatë të ngjarjeve vjetore të anuluar apo të shtyra për shkak të shqetësimeve për përhapje të sëmundjes Covid-19. Karnavali i shkollave të sambas në Rio de Zhaneiro nuk do të mbahet në muajin shkurt, sipas Ligës së Shkollave të Sambas në këtë vend. Në njoftimin e 24 shtatorit, kjo Ligë ka thënë se caktimi i datës së re do të varet nga vaksina. "Neve na duhet të presim muajt vijues për definicion rreth asaj nëse do të ketë vaksinë apo jo dhe se kur do

të ketë imunizim", ka thënë presidenti i Ligës, Jorge Castanheira, para gazetarëve në Rio.

Kjo ngjarje tërheq miliona turistë nga gjithë Brazili dhe pjesa tjetër e botës çdo vit.

Spekulime ka pasur edhe më herët që autoritetet do t'iu duhet të anulojnë apo shtyjnë këtë ngjarje, marrë parasysh se Brazili është duke tentuar ta kontrollojë përhapjen e koronavirusit.

Ky vend deri më tani ka regjistruar 4.7 milionë persona të infektuar dhe gati 140 000 vdekje nga Covid-19. Brazili njëherësh

është vendi i dytë në botë për nga numri i viktimave, pas Shteteve të Bashkuara, të cilat, sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", kanë regjistruar më shumë se 200 000 persona të vdekur me këtë virus.

Njoftimi për karnavalin në Rio ka ardhur teksa shumë shtete evropiane, duke përfshirë Francën, Britaninë dhe Spanjën kanë bërë të ditura kufizime të reja, për t'i parandaluar shpërthimet e reja të virusit.

Spanja, Izraeli, Argjentina dhe India kanë qenë shtetet me numrin më të madh të të infektuarve më 24 shtator. Në



gjithë botën numri i të infektuarve me këtë virus ka arritur në 32 milionë. Prej tyre, 981 000 pacientë kanë vdekur.

## Katër të plagosur në një sulm pranë ish-zyrës së "Charlie Hebdo"-s



PARIS, 25 SHTATOR - Policia në Paris ka njoftuar se katër persona janë plagosur në një sulm me thikë pranë ish-zyrës së revistës satirike

"Charlie Hebdo". Kjo e fundit ka qenë skenë e një sulmi terrorist në vitin 2015, ku kanë mbetur të vrarë 12 njerëz.

Policia ka njoftuar se dy nga

të plagosurit janë në gjendje kritike, për të shtuar se një i dyshuar është arrestuar. Autoritetet fillimisht besuan se dy sulmues kanë qenë të

përfshirë, por tani thonë se bëhet fjalë për një person i cili është arrestuar pranë Sheshit Bastille, në lindje të Parisit.

# Romani i Fitzgerald që nuk përfundoi kurrë

Ishte vetëm 44 vjeç kur, në një natë dhjetori të 1940, pasi u kthye i pirë nga një shfaqje, Fitzgerald e la jetën e vet veç në librat që shkroi gjatë saj. Shumë i njohur për romanet e quajtur “të epokës së jazz-it” mes të cilëve në krye qëndron “Getsbi i madh”, jeta e tij ishte në vetvete një histori e denjë për t’u shndërruar në fabul libri. Sipas kritikës, duket se ashtu ndodhi pasi vepra në fjalë, për shumëkënd, tregon pikërisht dinamikën e jetës së tij me të shoqen, Zelda Sayare.

Sot është data kur filloi të shkruhej libri volumpak por kuptimthellë i jetës së tij, faqe nga i cili u ngjiten pazgjidhshëm në librin e historisë së letërsisë. Çfarë duam të kujtojmë sot është fati i pafat i veprës që Fitzgerald filloi të shkruante në tetor të 1939 pa e mbaruar asnjëherë, titulluar “Manjati i fundit” (The last Tycoon). Botimi asaj pjese të shkruar ndodhi postum në 1941, nën kujdesin e kritikut Eduard Wilson.

Libri përmban gjashtë kapituj

të plotë, një përmbledhje të shkurtër dhe disa shënime që pati lënë vetë autori. Ai është një “akuzë” për Hollivudin ku Fitzgeraldi në rini pati një karrierë zhgënjyese si skenarist.

Subjekti trajton historinë e Monroe Stahr, një drejtor në industrinë e filmit i cili ka punuar shumë për të prodhuar filma me cilësi të lartë, pa marrë parasysh ndonjë fitim të mundshëm. Ai kujdesej personalisht për gjithçka, përfshirë edhe punonjësit e studios së tij. Në moshën 35 vjeçare, thuhet se ai humbet kontrollin mbi punën dhe jetën e tij.

Nuk dihet nëse ky fakt ka ndikuar apo jo, por duhet thënë se në fillim, kur ishin vetëm të fejuar, Zelda vendosi të ndahej nga Fitzgerald për shkak të paqëndrueshmërisë së tij financiare. Por pavarësisht çdo gjëje, F. Scott Fitzgerald mbetet një ndër ata etalone matëse të letërsisë së mirë.

*Përgatiti për “ExLibris”: A.D.*



## Origjina e emrave të markave më të famshme

**Cila** është historia që fshihet pas disa prej sipërmarrjeve më të rëndësishme në botë. Më poshtë shohim se disa emra markash erdhën nga përkthime, shpikje, dhe receta.

**Nike-** është emër që lidhet me perëndeshën e antikitetit grek, ku flatrat e fitores gjenden edhe në logon e kompanisë së njohur të veshjeve sportive.

**Adidas-** Nuk janë pak ata që besojnë historinë që thotë që emri është akronimi i fjalisë “All Day I Dream About Soccer”. Por origjina e emrit është tepër e thjeshtë, praktikisht është firma e krijuesit të saj Adolf Dasler, që të gjithë thërrisinin Adi.


**Audi-** Themeluesi, August Horch, iu sugjerua të përkthente në latinisht mbiemrin e tij, që në gjermanisht është i përafërt me fjalën “horën”, që do të thotë “dëgjo”, dhe që në latinisht përkthehet pikërisht “audi”.

**Zara-** Një nga firmat më të njohura të veshjeve, e ka ndryshuar emrin e saj me shpejtësi. Themeluesi Amancio Ortega e kishte regjistruar si Zorba, nga filmi i njohur i viteve '60, por dyqani i parë në La Korunja ishte jo larg një restoranti që quhej pikërisht Zorba dhe Ortega. Kështu, për të mos shqetësuar komshinjtë e ndryshuan në diçka të ngjashme.

**Pepsi-** Farmacisti Caleb Davis Bradham shpiku një pije me bazë uji, sheqeri, karameli dhe limoni që e quajti “Pepsi Cola”, nga fjala dispepsia, që tregon vështirësinë e tretjes.

**Starbucks-** Emri për zinxhirin e famshëm të kafesë u krijua nga pronarët e saj pothuajse rastësisht. Ata u mblodhën një mbrëmje dhe filluan të krijojnë fjalë që filluan me “st” pasi mendonin se këto 2 shkronja ishin një kombinim i shkëlqyeshëm. Më pas miqtë e tyre kujtuan një nga personazhet e Moby Dick, Starbuck.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Nixha: Liga Unike, sfidë për të gjithë

“Liga Unike është sfidë për të gjithë, sidomos në këtë kohë të pandemisë. Klubet duhet të jenë shumë të përgatitura dhe aspekti financiar do të jetë sfidë për klubet tona. Do të mbetet të shihet se si do të funksionojë”, ka thënë profesor Masar Nixha



**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Një nga personat që ka kontribuar për dekada të tëra në basketbollin e Kosovës është Masar Nixha. Ai ka komentuar krijimin e Ligës Unike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. “Liga Unike është sfidë për të gjithë, sidomos në këtë kohë të pandemisë. Klubet duhet të jenë shumë të përgatitura dhe aspekti financiar do të jetë sfidë për klubet tona. Do të mbetet të shihet se si do të funksionojë”, ka thënë profesor Nixha për faqen zyrtare të FBK-së.

Ish-basketbollisti, ish-trajneri i njohur dhe ish-kryetari i Këshillit Profesional shpreson që Liga do të zgjerohet edhe më shumë. “Besoj se mund të rritet interesimi (Kosovë e Shqipëri), por nëse inkuadrohen edhe shtete të tjera, sidomos ato fqinje, siç është Mali i Zi apo Maqedonia Veriore, interesimi mund të rritet edhe më shumë. Kjo mund ta bëjë edhe më interesante këtë ligë”, ka shtuar Nixha.

Ai shpreh mendimin që lojtarëve të rinj vendorë duhet t’u jepet më shumë

hapësirë. “Skuadrat duhet të marrin më së shumti dy lojtarë të huaj dhe në parket të paraqiten me tre basketbollistë vendorë. Lojtarëve të rinj duhet t’u jepet hapësirë dhe mund të përfitojnë nga kjo ligë”, ka thënë profesor Masar Nixha. Në Ligën Unike do të luajnë katër skuadrat më të mira të Kosovës dhe katër më të mirat nga Shqipëria. Kjo ligë pritet të fillojë në fund të muajit tetor. Liga Unike është krijuar në mes të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit.

## SHKURT

### Mekaj rikthehet te KB Ylli

Leonard Mekaj është rikthyer te KB Ylli. Reprezentuesi i Kombëtares së Kosovës është zyrtarizuar te skuadra nga Theranda. Ai ka nënshkruar për një vit me Yllin, pjesë e të cilës skuadër ka qenë edhe në të kaluarën. Mekaj sezonin e fundit ishte pjesë e KB Rahovecit, ku zhvilloi vetëm dhjetë ndeshje. Basketbollisti gjatë sezonit të kaluar u përballë me shumë lëndime.

### Genoa arrin marrëveshje me Balotellin

Sulmuesi italian Mario Balotelli duket pranë një kalimi te Genoa. Sipas raportimeve, sulmuesi do të nënshkruajë një kontratë njëvjeçare me opsion edhe për një vit tjetër në Marasi. Genoa ka qenë e lidhur me një transferim të mundshëm të italianit, pasi Balotelli do të largohet nga Bresha pas rënies në Serinë B. Sipas raportimeve, vetëm formalitetet po ndajnë klubin elitare të Italisë nga sulmuesi që dikur mbrojti ngjyrat edhe të Interit, Milanit, Manchester Cityt dhe Liverpoolit.

### Drita pas sukseseve, fiton 1 milion e 30 mijë euro

Drita i ka përfunduar garat ndërkombëtare, pasi të enjten në mbrëmje ka pësuar humbje nga skuadra e Legias (2-0). Rrugëtimi i suksesshëm deri në raundin e tretë të Ligës së Evropës ka mbushur arkat e klubit, pasi gjilanasit kanë siguruar disa bonuse shumë të rëndësishme nga UEFA. Në total Drita ka fituar 1 milion e 30 mijë euro. Fillimisht kampionia e Kosovës do të marrë 260 mijë euro nga UEFA për faktin se është shpallur kampione në Superligë.

Për pjesëmarrjen në fazën preliminare të Ligës së Kampionëve, gjilanasit do të fitojnë 230 mijë euro. Pas humbjes në tavolinë ndaj Linfieldit, bardhekaltrit përfunduan në raundin e dytë të Ligës së Evropës, ku skuadrat që luajnë në këtë rreth, marrin 260 mijë euro. Pas fitores ndaj Sileksit, Drita u kualifikua në raundin e tretë kualifikues të Ligës së Evropës, duke përfutur edhe 280 mijë euro për kalimin në këtë rreth, ku u eliminua nga Legia. Klubi nga Gjilani është shpërblyer me 30 mijë euro edhe nga Federata e Futbollit të Kosovës për fitimin e titullit kampion në edicionin 2019/2020.

## Sot zhvillohen dy ndeshje në elitë


**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje në Superligën e Kosovës në futboll. Në Drenas, Feronikeli e pret skuadrën e Drenicës me synim që t’u rikthehet fitoreve pas humbjes

së lartë që pësoi nga Ballkani në mesjavë. Në anën tjetër, kuqezinjët, e motivuar me tri pikët e fituara ndaj Besës, kërkojnë që edhe në këtë ndeshje të nxjerrin një rezultat pozitiv. Ndeshja tjetër që

zhvillohet sot është ajo në mes të Trepçës '89 dhe Llapit. '89-shi pushoi në xhiron e dytë, kurse Llapi pësoi humbje nga Gjilani dhe tash synon që ta shijojë fitoren e parë në këtë edicion.

Derbi në mes të Gjilanit dhe Ballkanit zhvillohet nesër (e diel), derisa ndeshja mes të Prishtinës dhe Dritës është shtyrë për shkak se klubi nga Gjilani të enjten luajti në Ligën e Evropës.




**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
 Univerziteti i Kosovës i Klinikës dhe Spitalit - Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
 SPITALI PËRGJITHSHËM - OPSTA BOLNIČA - GENEL HASTANESI "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren

Mbështetur në Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluejtshme të Spitalit të përgjithshëm duke u bazuar në Nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-144 Nenit 13 pika 1.1. Statutit të spitalit në mbledhjen e vetë të mbajtur me 25.09.2019 vendosi të shpall:

**FTESË PËR OFERTË**

**Për dhënen me qera të parkingut të spitalit: Shfrytëzim Afatëshkurtër**

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_  
 Menaxheri i OE: \_\_\_\_\_  
 Adresa: \_\_\_\_\_  
 Nr. Telefonit: \_\_\_\_\_  
 Çmimi i ofruar për një (1) muaj: \_\_\_\_\_

- Parkingu i spitalit jepet me qera në kohëzgjatje prej Tre (3) vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- të drejtë pjesëmarrje në këtë ofertë kanë të gjithë OE të cilët e kanë të regjistruar veprimtarinë ekonomike.
- OE të cilët marrin pjesë në këtë ofertë duhet të sjellin këto dokumente:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit ARBK (duke përfshirë numrin fiskal)
- Certifikatën e TVSH-së
- Vërtetimin e administratës tatimore e cila ka afatshmëri
- Vërtetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. (Orogjinal ose të Noterizuar)

Fitues i kësaj ftese për ofertë do të jetë OE i cili i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara më lartë si dhe ai i cili ofron çmim më të lartë të qeras në muaj për shfrytëzimin e parkingut të spitalit.


Fituesi ka për detyrë të bëjë sigurimin e automjeteve në parking 24 orë në ditë, të mos lejohet parkimi i automjeteve jashtë vendeve të caktuara për parking.

Aplikacioni për pjesëmarrje për ftesë për ofertë për dhënie me qera të parkingut të spitalit tërhiqen në zyrën nr. 2 në administratën e spitalit të përgjithshëm në Prizren prej dt. 25.09.2020 deri më dt. 09.10.2020 nga ora 08.00 deri në ora 14.00.

Ofertat dorëzohen në zarfë të mbyllur der me dt.09.10.2020 në zyrën nr. 2 në administratën e spitalit të përgjithshëm në Prizren deri në ora 11.00

Hapja e ofertave do të bëhet me dt.09.10.2020 në ora 11.30 në sallën e Entit higjienik.

DREJTORI  
 Prof. Ass. Dr. Afrim AYDAJ

  
 13/1  
 25.09.2020

Njësia Org. \_\_\_\_\_  
 Org. Jodhënës \_\_\_\_\_  
 Org. Ndihmës \_\_\_\_\_  
 Nr. i faqeve \_\_\_\_\_  
 Br. stranjës \_\_\_\_\_  
 Sayfa no. \_\_\_\_\_

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**


- ▶ Asim Hamdi Kasimlar shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.L.P "Ymer Prizreni" Prizren.
- ▶ Leotrim Qollopeku shpall të pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Rina Binaj shpall të pavlefshme deftesat e kl I - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Arbane.
- ▶ Gezim Stajku shpall të pavlefshme deftesat e vitit I, II, III, IV shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Violeta S. Ismajli B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810961210.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275


**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:


- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**Lume's Details**

**Estetik & Depilim**





044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 260/1  
Dt: 25.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### Ri SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për profilin Teknik i Optikës me 10 orë mësimore:	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 261/1  
Dt: 25.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës 20 orë mësimore:	Vendi i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

#### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.





ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

